



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 32

2002

Korrik

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8907 datë 6.6.2002	Për funksionimin e Institutit Gjeografik Ushtarak të Shqipërisë.....	1027
Ligj nr. 8912 datë 13.6.2002	Për një ndryshim në ligjin nr. 8810, datë 17.5.2001 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të Shoqërisë Anonime “Albtelecom””	1031
Vendim i Kuvendit nr.47, datë 20.6.2002	Për miratimin e “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e komisionit të shërbimit civil”	1032
Vendim i Kuvendit nr. 48, datë 24.6.2002	Për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë.....	1038
Dekret nr. 3372 datë 17.6.2002	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	1039

LIGJ
Nr. 8907, datë 6.6.2002

PËR FUNKSIONIMIN E INSTITUTIT GJEOGRAFIK USHTARAK TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Objekti dhe misioni

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i detyrave, i pozicionit shkencor dhe prodhues të Institutit Gjeografik Ushtarak të Shqipërisë, si institucion shtetëror dhe agjenci hartografike kombëtare për gjeodezinë dhe hartografinë shqiptare.

Instituti ka si mision mbështetjen gjeografike të veprimeve ushtarake të Forcave të Armatosura.

Neni 2

Përkufizimet

Në kuptim të këtij ligji:

1. “Gjeodezi” nënkupton shkencën që studion trajtën e tokës dhe përmasat e saj.
2. “Hartografi” nënkupton shkencën që merret me hartimin e hartave.
3. “Gjeografik” ka të bëjë me gjeografinë dhe dukuritë që janë objekt i saj.
4. “Rrjeti gjeodezik” nënkupton tërësinë e pikave të përcaktuara me koordinata në sipërfaqen e tokës në një sistem koordinativ të caktuar. Këtu përfshihen rrjeti i pikave të kontrollit horizontal dhe rrjeti i nivelimit.
5. “Përgatitja gjeografike” nënkupton grumbullimin e të dhënave për elementet e mjedisit biofizik dhe social, me dukuritë e tyre në hapësirë.
6. “Astronomi” nënkupton shkencën që merret me studimin e trupave qiellorë dhe me ligjet e lëvizjes së tyre.
7. “Fotogrametri” nënkupton shkencën që merret me mënyrën e përpunimit dhe të shfrytëzimit të fotografive ajrore për qëllime studimore dhe hartografike.
8. “Remote-sensing” nënkupton shkencën që merret me studimin dhe përpunimin e të dhënave që merren nga fotografimi i sipërfaqes së tokës prej satelitit.
9. “Menaxhimi hapësinor i mjedisit” nënkupton trajtimin shkencor të gjithanshëm të mjedisit.
10. “Filmi” nënkupton shiritin e celuloidit ku fiksohen pamjet e fotografuara të mjedisit gjeografik.
11. “Koordinata” nënkupton madhësitë që përcaktojnë pozicionin e një pike mbi sipërfaqen e tokës në tri përmasa (X, Y, H).
12. “Graviteti” nënkupton rëndesën, tërheqjen gravitacionale ose tërheqjen e rëndesës.
13. “Gjeoidi” nënkupton trupin që formohet nga ndërprerja e përfytyruar e tokës prej rrafshit të nivelit mesatar të deteve dhe të oqeaneve.

14. “Niveli mesatar i detit Adriatik dhe detit Jon” nënkupton nivelin e përcaktuar nga studimi shumëvjeçar i nivelit të detit Adriatik dhe detit Jon, nga të dhënat e matura dhe të përpunuara nga aparaturat (mareografë) të vendosura në pikat ujore bregore të Shëngjinit, të Durrësit, të Vlorës dhe të Sarandës.

15. “Projeksioni” nënkupton figurën gjeometrike të tokës, me paraqitje matematike të rregullt, ku projektohen të dhënat që përbëjnë hartat.

16. “WGS 84” nënkupton Sistemin Ndërkombëtar Gjeodezik të vitit 1984.

17. “Simbolet e hartave” nënkuptojnë tërësinë e shenjave konvencionale në hartë.

18. “Përtëritja e hartave” nënkupton shtimin e objekteve të reja për azhurnimin e hartave.

19. “E drejta e autorit” nënkupton të drejtën e njohur me ligjin nr.7564, datë 19.5.1992 “Për të drejtën e autorit”.

Neni 3

Varësia

Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë varet dhe financohet nga Ministria e Mbrojtjes dhe ka stemën dhe vulën e vet, e cila miratohet nga Ministri i Mbrojtjes.

Neni 4

Veprimtaria

1. Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë (më poshtë do të përdoret IGJUSH) është institucioni shtetëror ushtarak, i cili realizon veprimtari kërkimore-shkencore dhe projektim e prodhim.

2. Ky institut është përgjegjës për hartografimin masiv tokësor, detar dhe ajror të Republikës së Shqipërisë, si dhe është autori i ndërtimit dhe i mirëmbajtjes së rrjetit gjeodezik shtetëror, veprimtari të cilat i kryen për mbrojtjen dhe zhvillimin ekonomik të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Bashkëpunimi me jashtë në fushën e mbrojtjes

1. IGJUSH-i është përgjegjës për përgatitjen dhe mbështetjen gjeografike të veprimtarive ushtarake të vendit dhe të vendeve të NATO-s e të partneritetit për paqen, si dhe të operacioneve shumëkombëshe dhe humanitare, që mund të ndërmerren në hapësirën e Republikës së Shqipërisë.

2. IGJUSH-i ka të drejtë të kryejë edhe veprimtari të tjera në mbështetje të zhvillimit të ekonomisë kombëtare.

Neni 6

Detyrat në fushën e gjeodezisë

Në fushën gjeodezike IGJUSH- i përgjigjet për:

a) projektimin, matjen dhe përpunimin e të dhënave për krijimin, përtëritjen dhe mirëmbajtjen e rrjetit gjeodezik shtetëror (horizontal dhe vertikal) të Republikës së Shqipërisë;

b) kryerjen e përcaktimeve astronomike, gjeodezike, për orientimin e rrjetit gjeodezik shtetëror në sisteme rajonale dhe botërore;

c) projektimin, matjen dhe llogaritjen e përbërësve të gravitetit, në përcaktimin e gjeoidit shqiptar;

ç) studimin e nivelit mesatar të detit Adriatik dhe detit Jon, si dhe në njësimin e të dhënave vertikale me treguesit rajonalë dhe botërorë;

d) nxjerrjen e të dhënave të vendndodhjes (koordinatat dhe lartësinë) në ndihmë të ushtrisë.

Neni 7

Detyrat në fushën e hartografisë

Në fushën hartografike IGJUSH-i përgjigjet për:

a) studimin, grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave hapësinore për krijimin dhe botimin e hartave topografike në hapësirën tokësore, ajrore dhe detare të Republikës së Shqipërisë në shkallët 1: 10 000 – 1: 1 000 000 dhe i prodhon, përtërin e shpërndan në të gjithë strukturën e Forcave të Armatosura, në ndihmë të institucioneve studimore e projektuese shtetërore të administratës civile, biznesit dhe sistemit të edukimit;

b) krijimin e bazës së të dhënave të domosdoshme për hartimin numerik (dixhital) dhe konvencional të prodhimeve hartografike;

c) studimin, përzgjedhjen dhe kryerjen e fotografimeve ajrore, si dhe grumbullimin, përpunimin e të dhënave të pamjeve satelitore e remote-sensing, për qëllime topografike dhe tematike;

ç) rivlerësimin dhe hartimin e planeve topografike në shkallë të mëdha të hapësirave infrastrukturore të njësisive dhe reparteve ushtarake, të pasurive të paluajtshme të ushtrisë, për studimin dhe projektimin inxhinierik të veprave ushtarake.

Neni 8

Detyrat për pasqyrimin topografik të kufijve shtetërorë

IGJUSH-i është përgjegjës për pasqyrimin topografik dhe vëzhgimin periodik të kufijve shtetërorë të Republikës së Shqipërisë, në përputhje edhe me marrëveshjet ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 9

Krijimi i Bordit të Gjeoinformacionit

1. Pranë IGJUSH-it krijohet Bordi i Gjeoinformacionit me përfaqësues nga Akademia e Shkencave, Universiteti Politeknik i Tiranës, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria e Mjedisit, si dhe dy përfaqësues nga agjencitë hartografike private.

2. Përbërja, funksionimi dhe detyrat e këtij bordi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Bashkëpunimi me institucionet e tjera

IGJUSH-i bashkëpunon me Akademinë e Shkencave dhe institucionet e saj për tematikat e studimeve, të kërkimeve, zbatimeve dhe eksperimentimeve në fushat e gjeodezisë së lartë, gjeografisë, hartografisë, fotogrametrisë dhe remote-sensing-ut.

Neni 11

Dhënia e autorizimit për fotografim ajror

Autorizimin për fotografimin ajror, të pjesshëm ose të përgjithshëm, të hapësirës së Republikës të Shqipërisë nga agjenci shtetërore ose private, brenda dhe jashtë vendit, e jep Ministri i Mbrojtjes.

Neni 12

Kontrolli dhe administrimi i aerofilmove

IGJUSH-i kontrollon, shoqëron dhe administron aerofilmat burimorë të të gjitha fotografimeve ajrore, të kryera nga institucione, agjenci shtetërore dhe private, shqiptare ose të huaja, duke mos lejuar shpërdorimin e të dhënave në dëm të sigurimit kombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Neni 13

Detyrimet e agjencive dhe institucioneve të tjera

Agjencitë dhe institucionet hartografike e gjeodezike, si dhe ato projektuese, shtetërore ose private, janë të detyruara të arkivojnë pranë IGJUSH-it një kopje të rivlerësimeve (fletë-harte) ose një format dixhital (CD, disketë) të planeve ose hartave, që krijojnë dhe prodhojnë, të projekteve ndërtimore (të qyteteve, fshatrave, rrugëve, hekurudhave, ujëmbledhësve, linjave të tensionit dhe telekomunikacionit, porteve, aeroporteve, ndërtimeve bregore, trajtimeve të pyjeve dhe kullotave, rrjeteve inxhinierike, objekteve shoqërore dhe ekonomike). Këto materiale do të shfrytëzohen për qëllime ushtarake dhe për përtëritjen e hartave topografike, që do të përdoren nga të gjitha agjencitë e tjera, si harta topografike gjithëvendore.

Neni 14

Mendimi për licencim të personave fizikë dhe juridikë

IGJUSH-i, nëpërmjet Bordit të Gjeoinformacionit, ka të drejtë të japë mendime teknike dhe shkencore për krijimin, lejimin dhe licencimin e personave fizikë dhe juridikë, që kryejnë veprimtari private në fushat e gjeodezisë, hartografisë, fotogrametrisë dhe remote-sensing-ut, të cilat duhet të merren parasysh në procedurat ligjore.

Neni 15

Arkivi

1. Pranë IGJUSH-it funksionon arkivi hartografik dhe gjeodezik, ku ruhen dhe menaxhohen studimet, matjet, llogaritjet dhe përpunimi i të dhënave burimore, hartimi dhe botimi, aerofilmat, filmat (negativë dhe pozitivë), planet dhe hartat topografike, të dhënat gjeografike dixhitale (raster dhe vektor data).

2. Veprimtaria e këtij arkivi kryhet në mbështetje të ligjit nr.7726, datë 29.6.1993 "Për fondin arkivor dhe për arkivat".

Neni 16

Mbështetja financiare për projektet kombëtare

Kërkesa për mbështetje financiare, pas hartimit, diskutimit dhe miratimit të projekteve kombëtare, si rrjeti gjeodezik shtetëror, studimet gravimetrike, fotografimet ajrore, nxjerrja dhe shfrytëzimi i të dhënave të remote-sensing-ut, studimi i nivelit të detit Adriatik e detit Jon, paraqitet jo më pak se 1 vit para zbatimit të tyre.

Neni 17

Të ardhurat nga veprimtaria me të tretët

IGJUSH-i kryen veprimtari me të tretët, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shpërndarja e të ardhurave që sigurohen nga veprimtaria me të tretët përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 18
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet në zbatim të neneve 9 dhe 18 të këtij ligji.

Neni 19
Shfuqizime

Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që vijnë në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3389, datë 28.6.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

LIGJ
Nr. 8912, datë 13.6.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8810, DATË 17.5.2001 “PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE TË STRUKTURËS SË FORMULËS SË PRIVATIZIMIT TË SHOQËRISË ANONIME “ALBTELECOM””

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8810, datë 17.5.2001 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime “Albtelecom”” bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 6 të ligjit nr.8810, datë 17.5.2001, emërtimi “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit” ndryshohet dhe zëvendësohet me “Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3384, datë 26.6.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

VENDIM
Nr. 47, datë 20.6.2002

**PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL”**

Në mbështetje të nenit 5 pika 12 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe të nenit 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Shërbimit Civil,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Miratohet “Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Shërbimit Civil” sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Kjo Rregullore përcakton rregullat e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Shërbimit Civil, kompetencat e tij dhe të Sekretariatit Teknik, drejtimit kryesorë të punës së Komisionit të Shërbimit Civil dhe marrëdhëniet midis tij, Kryetarit dhe Sekretariatit Teknik.

Neni 2
Baza juridike për funksionimin dhe veprimtarinë e Komisionit

Komisioni i Shërbimit Civil funksionon dhe ushtron veprimtarinë e tij në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, me ligjin nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me aktet e tjera ligjore e nënligjore, si dhe me këtë Rregullore.

Neni 3
Parimet e veprimtarisë

Veprimtaria e Komisionit të Shërbimit Civil është e ndërtuar dhe zhvillohet në bazë të parimeve të pavarësisë, integritetit, paanësisë politike, profesionalizmit, transparencës dhe ligjshmërisë për garantimin e mbrojtjes së të drejtave të nëpunësit civil dhe zbatimit prej tyre të detyrimeve si të tilla, me qëllim që të krijohet një shërbim civil i qëndrueshëm, profesionist dhe veprues.

KREU II
DREJTIMI DHE KOMPETENCAT E KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Neni 4

Kompetencat e Komisionit të Shërbimit Civil

Komisioni i Shërbimit Civil ushtron kompetencat e tij në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, neni 8 i tij.

Neni 5

Detyrimi i institucioneve

Të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, janë të detyruara të vënë në dispozicion të Komisionit të Shërbimit Civil dokumentacionin e nevojshëm për sqarimin e çështjes, objekt i punës së Komisionit.

Neni 6

Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit

1. Komisioni i Shërbimit Civil, me votim të fshehtë, zgjedh Kryetarin dhe Zëvendëskryetarin prej anëtarëve të tij.

2. Kryetar ose Zëvendëskryetar zgjidhet respektivisht anëtari i Komisionit të Shërbimit Civil që ka fituar shumicën e votave të të gjithë anëtarëve.

3. Kryetari i Komisionit të Shërbimit Civil zëvendësohet në rastet e parashikuara nga pika 5 e nenit 5 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”. Zëvendësimi i Kryetarit bëhet sipas së njëjtës procedurë, brenda 10 ditëve nga krijimi i vendit vakant. Në periudhën ndërmjetëse detyrat e Kryetarit kryhen nga Zëvendëskryetari i Komisionit. Gjithashtu, Zëvendëskryetari kryen detyrën e Kryetarit, në mungesë të këtij të fundit ose kur ngarkohet me porosi të tij.

4. Mbledhjen e Komisionit të Shërbimit Civil për zgjedhjen e Kryetarit të parë e thërret Kryetari i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrat e Kryetarit

Kryetari i Komisionit të Shërbimit Civil, përveç detyrave të parashikuara në pikën 4 të nenit 5 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, kryen edhe këto detyra:

- a) përcakton rendin e ditës, thërret mbledhjen e Komisionit dhe drejton diskutimet e tij;
- b) përfaqëson dhe shpreh qëndrimin e Komisionit të Shërbimit Civil në marrëdhënie me të tretët dhe për çdo rast informon Komisionin;
- c) planifikon dhe realizon mbledhjet për analizat periodike ose tematike, programet e punës së Komisionit të Shërbimit Civil; cakton dhe ndjek në mënyrë të vazhdueshme realizimin e detyrave të ngarkuara prej tij ose nga mbledhja e Komisionit të Shërbimit Civil;
- ç) kontrollon publikimin dhe njoftimin e vendimeve.

Neni 8

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Komisionit të Shërbimit Civil

1. Anëtarët e Komisionit të Shërbimit Civil marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e Komisionit, si dhe kryejnë detyra të veçanta të ngarkuara nga Komisioni.

2. Anëtari i Komisionit të Shërbimit Civil mund të mungojë në detyrë për shkaqe të përligjura, por në çdo rast duke respektuar afatin e parashikuar në shkronjën “d” të pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

3. Anëtari i Komisionit të Shërbimit Civil ka të drejtë të informohet në çdo kohë për të gjitha problemet dhe ankesat që janë në kompetencë të Komisionit. Në çdo rast, anëtari i Komisionit të Shërbimit Civil ka të drejtë të ngrejë probleme për t'u trajtuar në mbledhjet e Komisionit, duke ndjekur procedurën e përcaktuar në këtë Rregullore.

4. Anëtari i Komisionit të Shërbimit Civil në mbledhje shfaq mendimet e tij, bën vlerësime dhe vërejtje, si dhe propozime për mënyrën e zgjidhjes së problemit që diskutohet. Ai ushtron funksionet në mënyrë individuale dhe voton lirisht, sipas bindjes së tij të brendshme.

5. Anëtari i Komisionit të Shërbimit Civil ngarkohet me detyra nga mbledhja e Komisionit dhe është përgjegjës për zbatimin e tyre. Për realizimin e detyrave të ngarkuara ai ndihmohet nga Sekretariati Teknik.

Neni 9

Zëvendësimi i anëtarit të Komisionit të Shërbimit Civil

Kryetari i Komisionit të Shërbimit Civil, 30 ditë para mbarimit të mandatit të anëtarit të Komisionit, njofton Kuvendin për të nisur procedurat e zëvendësimit të këtij anëtar, sipas nenit 5 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil". Anëtari i Komisionit të Shërbimit Civil qëndron në detyrë deri në zëvendësimin e tij.

KREU III

FUNKSIONIMI I KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Neni 10

Mbledhja e Komisionit të Shërbimit Civil

1. Komisioni i Shërbimit Civil mbledhet jo më pak se dy herë në muaj. Mbledhjet e Komisionit të Shërbimit Civil thirren nga Kryetari dhe në mungesë të tij nga Zëvendëskryetari ose me kërkesë me shkrim të dy anëtarëve të Komisionit të Shërbimit Civil.

2. Kryetari dhe në mungesë të tij Zëvendëskryetari vendos për datën, vendin dhe kohën e mbledhjes së radhës. Çdo ndryshim për datën, vendin dhe kohën e vendosur për mbledhjen e radhës, i njoftohet me shkrim çdo anëtar të Komisionit të Shërbimit Civil, me qëllim që ai të njihet me këto ndryshime.

3. Mbledhjet e Komisionit të Shërbimit Civil janë të hapura për shqyrtimin e ankesave; Komisioni është i detyruar të njoftojë dhe të dëgjojë palët e interesuara; ndërsa diskutimet dhe marrja e vendimit bëhen pa pjesëmarrjen e palëve.

Sekretar caktohet një nga nëpunësit e Sekretariatit Teknik.

4. Komisioni i Shërbimit Civil merr vendime vetëm për çështjet që janë përcaktuar në rendin e ditës së mbledhjes. Përjashtim është rasti i parashikuar nga pika 3 e nenit 11 të kësaj Rregulloreje, për të cilin Komisioni i Shërbimit Civil shprehet me vendim.

5. Komisioni i Shërbimit Civil, për çdo problem të rendit të ditës, merr vendim të veçantë.

Neni 11

Rendi i ditës

1. Mbledhja e Komisionit të Shërbimit Civil zhvillohet në bazë të një rendi dite të përcaktuar.

2. Kryetari i Komisionit të Shërbimit Civil, e në mungesë të tij Zëvendëskryetari, vendos për rendin e ditës për çdo mbledhje. Rendi i ditës duhet të përfshijë ato çështje, të cilat i janë propozuar drejtuesit nga anëtarët e Komisionit, si dhe çështje të tjera që ai çmon e që janë në kompetencë të Komisionit të Shërbimit Civil.

3. Kërkesa për të futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim, të paktën 5 ditë para fillimit të mbledhjes. Për raste të veçanta, kur natyra e problemit është urgjente, ky afat mund të jetë edhe më i shkurtër.

4. Rendi i ditës duhet t'u njoftohet me shkrim anëtarëve të Komisionit të Shërbimit Civil, të paktën 48 orë para fillimit të mbledhjes.

Neni 12 **Kuorumi**

Mbledhja e Komisionit të Shërbimit Civil është e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij, drejtuesi e ndërpret atë dhe vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, të paktën 24 orë më pas. Edhe në këtë rast mbledhja është e vlefshme nëse janë të pranishëm tre anëtarë të Komisionit të Shërbimit Civil.

Neni 13 **Votimi**

1. Vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

2. Kur në mbledhje marrin pjesë tre anëtarë të Komisionit të Shërbimit Civil, vendimi merret vetëm në rastin kur për të votohet unanimitisht pro ose kundër.

3. Anëtarët e Komisionit të Shërbimit Civil, të pranishëm në mbledhje, nuk mund të abstenojnë në votim.

4. Anëtarët e Komisionit të Shërbimit Civil, që kanë pengesë ligjore, nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë shqyrtimit, diskutimit dhe votimit të çështjes.

5. Vendimet në mbledhjet e Komisionit të Shërbimit Civil merren me votim të hapur. Me votim të fshehtë merren vendime që përmbajnë vlerësime për sjelljen ose cilësitë e një individi, ose të një nëpunësi të Komisionit të Shërbimit Civil.

Neni 14 **Barazia e votave**

Votat e anëtarëve të Komisionit të Shërbimit Civil janë të barabarta.

Neni 15 **Procesverbali i mbledhjes**

1. Në çdo mbledhje të Komisionit të Shërbimit Civil mbahet një procesverbal, ku pasqyrohen data, vendi, rendi i ditës, anëtarët pjesëmarrës në mbledhje, drejtuesi i saj, çështjet që janë diskutuar, forma dhe rezultati i votimeve, si dhe vendimet e marra.

2. Procesverbali mbahet nga sekretari dhe duhet t'u paraqitet për miratim gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje në fund të saj ose në fillim të mbledhjes pasardhëse.

3. Pas kësaj, procesverbali zbardhet e nënshkruhet nga drejtuesi i mbledhjes dhe nga sekretari.

Neni 16 **Vendimet e Komisionit**

1. Vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil janë të vlefshme kur për to ka votuar shumica e të gjithë anëtarëve të Komisionit.

2. Anëtarët e Komisionit të Shërbimit Civil që kanë votuar kundër, kanë detyrimin të shprehin të arsyetuar qëndrimin e tyre si mendim të pakicës.
3. Vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil zbardhen brenda tre ditëve nga marrja e tyre.
4. Sekretariati Teknik njofton të interesuarit për vendimet e marra nga Komisioni i Shërbimit Civil.
5. Afati dhe mënyra e njoftimit do të kryhen në bazë të neneve 59 e 60 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
6. Sekretariati Teknik publikon vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil.

KREU IV SEKRETARIATI TEKNIK I KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Neni 17

Struktura dhe detyrat e Sekretariatit Teknik

1. Komisioni i Shërbimit Civil ka Sekretariatit Teknik, si pjesë e strukturës organizative të tij.
2. Struktura dhe vendet e punës të Sekretariatit Teknik, si dhe çdo ndryshim në lidhje me to, vendosen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë mbi bazën e propozimit të Komisionit të Shërbimit Civil.
3. Sekretariati Teknik kryen detyra të një natyre ndihmëse, detyra të karakterit administrativ, organizativ, verifikues, informativ, këshillimor e teknik, si dhe çdo detyrë me karakter ndihmës në shërbim të Komisionit të Shërbimit Civil.
4. Nëpunësit e Sekretariatit Teknik janë nëpunës civilë.
5. Sekretariati Teknik drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 18

Organizimi dhe funksionimi i Sekretariatit Teknik

Organizimi dhe funksionimi i Sekretariatit Teknik të Komisionit të Shërbimit Civil përcaktohen në një rregullore të veçantë, e cila miratohet me vendim të Komisionit.

Neni 19

Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit të Shërbimit Civil

1. Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit të Shërbimit Civil është nëpunësi civil më i lartë i tij.
2. Sekretari i Përgjithshëm ka këto detyra:
 - a) drejton veprimtarinë e Sekretariatit Teknik dhe përgjigjet për mbarëvajtjen e punës së tij;
 - b) siguron dhe plotëson kushtet e nevojshme për anëtarët e Komisionit të Shërbimit Civil, për zhvillimin normal të veprimtarisë së tyre kolegjiale dhe individuale;
 - c) kujdeset e përgjigjet për përgatitjen në kohë të materialeve të mbledhjeve të Komisionit të Shërbimit Civil, sipas rendit të ditës të përcaktuar, duke vënë në dispozicion të anëtarëve të Komisionit të Shërbimit Civil materialet për shqyrtim;
 - ç) kujdeset dhe përgjigjet për zbardhjen në kohë të vendimeve, për njoftimin dhe publikimin e tyre;
 - d) drejton punën për përgatitjen e projektbuxhetit dhe përgjigjet për zbatimin e buxhetit të Komisionit të Shërbimit Civil;
 - dh) kryen detyra të tjera të karakterit administrativ, të caktuara nga Komisioni i Shërbimit Civil ose Kryetari i tij dhe përgjigjet për zbatimin e tyre.

3. Sekretari i Përgjithshëm emërohet dhe lirohet nga detyra me vendim të Komisionit të Shërbimit Civil, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

KREU V DOKUMENTACIONI I KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Neni 20

Dokumentet e Komisionit të Shërbimit Civil

Dokumentet kryesore të Komisionit të Shërbimit Civil janë:

- a) protokollin e përgjithshëm të hyrjes dhe daljes së korrespondencës;
- b) libri i shpërndarjes së korrespondencës;
- c) regjistri i ankesave;
- ç) regjistri i vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil;
- d) libri i inventarit të arkivit të Komisionit të Shërbimit Civil;
- dh) dokumente të tjera që burojnë nga aktet ligjore e nënligjore për institucionet shtetërore.

Neni 21

Korrespondenca

1. Korrespondenca që i drejtohet Komisionit të Shërbimit Civil pranohet, regjistrohet dhe i paraqitet Kryetarit të Komisionit të Shërbimit Civil.

2. Dokumentacioni i Komisionit të Shërbimit Civil pranohet, regjistrohet, përpunohet, sistemohet, arkivohet dhe ruhet sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

KREU VI EKSPERTËT DHE KËSHILLTARËT E JASHTËM

Neni 22

Thirrja e ekspertëve dhe e këshilltarëve të jashtëm

1. Për shfrytëzimin e përvojës në zgjidhjen e problemeve me karakter të veçantë që i dalin Komisionit të Shërbimit Civil, si dhe për rritjen e nivelit shkencor të punës së tij, mund të merren specialistë të fushave të ndryshme, me cilësinë e këshilltarëve dhe ekspertëve të jashtëm të përkohshëm.

2. Thirrja e ekspertëve dhe e këshilltarëve të jashtëm, koha e bashkëpunimit dhe pagesa e tyre rregullohen sipas dispozitave në fuqi dhe përcaktohen konkretisht në vendimin e Komisionit të Shërbimit Civil që merret për këtë rast.

KREU VII BUXHETI, TË ARDHURAT, SHPENZIMET DHE DONACIONET

Neni 23

Buxheti

1. Buxheti i Komisionit të Shërbimit Civil përbën zë të veçantë në Buxhetin e Shtetit.

2. Projektbuxheti i Komisionit të Shërbimit Civil përgatitet nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm, sipas ligjit përkatës për Buxhetin e Shtetit dhe i paraqitet Komisionit të Shërbimit Civil për shqyrtim dhe miratim.

3. Projektbuxheti i miratuar nga Komisioni i Shërbimit Civil ose çdo ndryshim i tij i dërgohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për të vendosur sipas ligjit.

Neni 24

Administrimi dhe realizimi i buxhetit

1. Komisioni i Shërbimit Civil administron fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit dhe nga burime të tjera të ligjshme, në shërbim të tij.

2. Realizimi i tyre bëhet nëpërmjet sektorit të financës të Komisionit të Shërbimit Civil.

Neni 25

Donacionet

1. Komisioni i Shërbimit Civil mund të përfitojë donacione të huaja të ndryshme në bazë të legjislacionit në fuqi, me kusht që të mos cenohen pavarësia dhe autoriteti i tij.

2. Administrimi i këtyre donacioneve do të bëhet sipas marrëveshjes me donatorët dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 26

Kontrolli financiar

Llogaritë financiare të Komisionit të Shërbimit Civil kontrollohen nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe nga kontrolli i brendshëm financiar i institucionit, që kryhet me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm.

KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM

Nr. 48, datë 24.6.2002

PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 86, 87 dhe 88 pika 2 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Alfred Moisiu zgjidhet President i Republikës së Shqipërisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Servet Pëllumbi**

DEKRET
Nr. 3372, datë 17.6.2002

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" të Kushtetutës, të neneve 24 dhe 19, si dhe të nenit 9, pika 7 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

1. Aleksandër Jani Vllashi
2. Varvara Petrit Vllashi
3. Kristina Aleksandër Bulku
4. Elife Daut Fejzullai
6. Halit Selim Myftari
7. Vehbije Malo Myftari
8. Thimaq Petraq Opari
9. Zhaneta Dhimitri Opari
10. Ilija Manol Emanuil
11. Asllan Hush Ibroja
12. Besnike Bashkim Ibroja (Premtimi)
13. Arta Asllan Ibroja
14. Albana Asllan Ibroja
15. Artur Asllan Ibroja
16. Isa Faik Hyseni
17. Lutfije Ramazan Hyseni
18. Elimia Isa Hyseni
19. Elton Isa Hyseni
20. Erion Isa Hyseni

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij:

1. Antonio Sciarra

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 3.7.2002
Doli nga shtypi më 4.7.2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 100 lekë